



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0447

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Poterqoi dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani, anëtarë duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.SH.H "Zona Park", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor" me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1, me 26/10/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE N.SH.H "Zona Park" me nr. 2023/0447, e datës 30/06/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor" me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.SH.H "Zona Park"

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 28.09.2022 ka paraqitur Njoftimin për kontratë- B05, për aktivitetin e prokurimit me titull "Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor" me numër të prokurimit 616-22-10416-2-1-1.

Me 09. 06. 2023, AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin vendim ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik "Ekologjia SHPK" & "Truly Nolen SHPK- Cen Dugolli".

Me 14.06.2023, OE "Zona Park" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 20.06.2023, AK Komuna Prishtinë ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit

Ekonomik ankues si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Zona Park" SH.P.K i pakënaqur me Vendimin e AK-së për dhënie të kontratës, me 30.06.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokolli 447/23.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 11.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës, aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se pajtohet pjesërisht me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Deklarimi i Ankuesit lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues: "Pajtohem pjesërisht me konstatimin e ekspertit sa i përket pretendimit nr. 2, ndërsa nuk pajtohem në lidhje me nënshkrimin e deklaratës nën betim, si dhe faktin se nuk është shqyrtuar pretendimi i tretë për informacione të rreme nga operatori i rekomanduar për kontratë. Konsiderojmë se eksperti nuk ka zbërthyer çështjen e nënshkrimit nga personi i cili nuk është drejtor i kompanisë. Eksperti gabimisht e ka trajtuar këtë çështje duke u bazuar vetëm në faktin se KRPP ka shfuqizuar pyetjet e shpeshta dhe pa e marrë në konsideratë Nenin 109 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare i cili i përcakton kompetencat e Drejtorit Menaxhues të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuara. Eksperti duhet të kishte marrë në konsideratë se personat të cilët nuk kanë cilësinë e drejtorit të regjistruar në ARBK nuk mund të nënshkruajnë deklaratë nën betim dhe as të marrin obligime në emër të SHPK-së pasi që nuk janë të autorizuar ligjërisht. Eksperti po ashtu nuk është marrë fare me pretendimin tjetër i cili kishte të bënte me kundërthënien në mes të informatave të ofruara për nga vet operatori Ekologjia për të punësuarin Visar Fera, ku deklaratën nën betim e ka nënshkruar si zyrtar administrativ, ndërsa në vërtetimin e punësimit të vet të punësuarit është

thënë se ai është shofer. Pra dokumentet dhe të dhënat e ofruara për këtë person janë kundërthënëse dhe mashtruese, ndërsa eksperti fare nuk i ka shqyrtuar ato”.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Pretendimet e Ankuesit “Zona Park” SHPK

- *Pretendimi i parë (I)*- Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës ka hapur aktivitetin e prokurimit me titull “Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor” me datë 29.09.2022. Zona Park brenda afatit të parashikuar në dosje të tenderit ka dorëzuar ofertën e vet, në përputhje me të gjitha kriteret e Ligjit të Prokurimit Publik dhe kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit. Me datë 14.04.2023 është publikuar procesverbali i hapjes së ofertave, nga ku vërehet se tri konsorciume kanë paraqitur ofertat e tyre. Nga të dhënat e procesverbalit po ashtu shihet se oferta ynë ishte e dyta më e lirë. Me datën 24.05.2023 është bërë publikimi i Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, me anë të të cilit vërehet se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës grupin e operatorëve ekonomik: “Ekologjia Sh.P.K. dhe Truly Nolen” Sh.P.K. Menjëherë kemi dërguar kërkesë për qasje në dokumente e tenderit dhe nga qasja kemi vërejtur se grupi i operatorëve ekonomik nuk është i përgjegjshëm sipas Ligjit të Prokurimit Publik dhe kërkesave të dosjes së tenderit. Brenda afatit ligjor kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim duke paraqitur arsyet për shkeljet e dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe duke kërkuar që lënda të kthehet në Rivlerësim. Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim e ka aprovuar të njëjtën pjesërisht dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim. Sidoqoftë këtij vendimi i ka munguar pjesa e arsyetimit si element esencial i aktit administrativ. Pas rishqyrtimit Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar sqarime shtesë operatorit të rekomanduar për kontratë dhe të njëjtin përsëri e ka rekomanduar për dhënie të kontratës, duke e lënë kështu të plotësoj lëndën kundërligjshëm me dokumente dhe informacione shtesë. Po ashtu gjatë rivlerësimit të ofertave ka vepruar kundërligjshëm duke kërkuar jashtë platformës së e-Prokurimit informacione shtesë.
- *Pretendimi i dytë (II)*- Deklarata nën betim e liderit të konsorciumit nuk është nënshkruar nga drejtori. Nga qasja në dokumente të konsorciumit kemi vërejtur se Deklarata nën betim e liderit të konsorciumit Ekologjia ShPK është nënshkruar nga personi me emrin Visar Fera i cili sipas të dhënave të ARBK nuk ka asnjë pozitë në kompaninë ekologjia dhe i njëjti nuk ka dorëzuar autorizim se ka të drejtë të nënshkruaj deklaratën nën betim në emër të operatorit ekonomik për të cilin pretendon se e përfaqëson. Se zyrtarët të cilët nuk kanë autorizim për të nënshkruar në emër të operatorit ekonomik nëse nuk janë drejtor të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë a ka sqaruar më së miri Ligji për Shoqëritë Tregtare tek Neni 109 [Autorizimi i Drejtorit Menaxhues për të Vepruar në Emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar] në të cilin thuhet shprehimisht se vetëm drejtorët e përfaqësojnë një

shoqëri me përgjegjësi të kufizuar përballë palëve të treta. Për më tepër se çfarë ndodh nëse personat që nuk kanë autorizim nënshkruajnë një deklaratë nën betim, e sqaron më së miri Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me numër 175/20, ku është thënë shprehimisht se personat e tillë nuk kanë të drejtë të nënshkruajnë në emër të ofertuesit nëse nuk kanë dorëzuar paraprakisht autorizim me të cilin janë lejuar nga kompania për nënshkrimin e dokumenteve të tilla. Për më tepër çështja e nënshkrimit të deklaratës nën betim nga personat e paaautorizuar ligjërisht është e sqaruar edhe tek pyetjet e shpeshta të KRPP-së, përkatësisht pyetja 40 nga e cila është e qartë se ai tender duhet të refuzohet. Autoriteti kontraktues edhe pse e ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim në lidhje me këtë, nuk e ka eliminuar operatorin, por i ka kërkuar sqarime shtesë përmes emailit, në kundërshtim me Nenin 38 të Rregullores së Prokurimit Publik 001/2022. Po ashtu operatori është përgjigjur përmes emailit në kundërshtim të po të njëjtës dispozitë dhe ka dërguar një autorizim të vitit 2019, një kontratë pune dhe një vërtetim të përvojës së punës. Nga analizimi i dokumenteve, vërehet se në autorizim i mungon e drejta e të autorizuarit që të ofertoj në procedurat e prokurimit publik si kategori e veçantë ligjore dhe se i mungon e drejta e të autorizuarit të nënshkruaj deklaratë nën betim. Për më tepër Kontrata e punës është e vitit 2022, ndërsa autorizimi është i vitit 2019. Për më tepër në vërtetimin e përvojës së punës thuhet qartë se i njëjti punon në këtë kompani si vozitës nga data 01.08.2013 e deri më sot, vërtetim ky i lëshuar më datë 02.06.2023. Pra, të dhënat në lidhje me këtë punonjës janë të pavërteta ose në kontratën e punës e cila është dorëzuar, ose në vërtetimin e përvojës së punës. Andaj nga Autoriteti Kontraktues kemi kërkuar që në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik Neni 92 paragrafi 2 të bëjë kërkesë që operatori të futet në listë të zezë për shkak të ofrimit të dhënave të rreme. Autoriteti Kontraktues nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të adresuar këtë shkelje të operatorit. Po ashtu meqë kemi të bëjmë me një autorizim relativisht të vjetër dhe jashtë periudhës së kontratës për personin e autorizuar, i kemi kërkuar Autoritetit Kontraktues që të verifikoj vërtetësinë e këtij akti noterial, qoftë duke e kërkuar kopjen origjinale apo duke e verifikuar vërtetësinë e të njëjtit me Noterin i cili e ka lëshuar këtë akt noterial. Për shkak se ky autorizim nuk është dorëzuar në fillim me ofertë në platformën e e-Prokurimit kemi arsye të dyshojmë ekzistencën e të njëjtit. Autoriteti kontraktues nuk e ka përfillur këtë kërkesë dhe ka vepruar pa e bërë verifikimin e aktit noterial.

- *Pretendimi i tretë (III)*- Kërkesat për sqarime të ofertës janë bërë jashtë platformës së e-prokurimit në kundërshtim me rregullat. Nga qasja në dokumente zyrtare, kemi kuptuar se i gjithë komunikimi me operatorin ekonomik është bërë përmes emailit dhe jo përmes platformës së e-prokurimit për sqarimin e tenderit. Kjo formë e komunikimit nuk i lejohet autoritetit kontraktues dhe as operatorit ekonomik, pasi që sipas Rregullores 001/2022 për Prokurimit Publik, Neni 38 paragrafi 8 thuhet: “Kërkesën për sqarim të tenderit AK duhet t’a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik. OE përgjigjen në “Kërkesën për sqarim të tenderit” duhet t’a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik”. Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim dhe shkelje të këtij rregulli kur ka komunikuar me operatorin ekonomik për çështjet e sqarimit të ofertës, nëpërmjet komunikimit alternativ jashtë platformës së e-prokurimit i cili sistem nuk është lehtë i gjurmueshëm për Komisionin Rregullativ të Prokurimit dhe as Organin Shqyrtues të Prokurimit. Prandaj, meqë integriteti i këtyre komunikimeve nuk mund të ruhet me komunikim direkt (inter partes) jashtë platformës së e-Prokurimit. Duke marrë për bazë të gjitha argumentet e cekura si më lartë, me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që pas shqyrtimit të të gjitha provave të nxjerr këtë vendim: Aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik Zona Park dhe të anulohet njoftimi për vendimin e autoritetit kontraktues dhe lënda kthehet në Rishqyrtim.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

- *Konstatimi i parë (I)*- Eksperti shqyrtues sqaron se GOE të rekomanduar për kontratë në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertë nga GOE përkatësisht “Ekologjia” ka dorëzuar deklaratën nën betim duke nënshkruar këtë deklaratë nga Visar Fera si përfaqësues i kompanisë "Ekologjia". Pretendimi ankimor se OE ankues nën deklaratën në betim duhet të nënshkruhet vetëm nga pronari i kompanisë apo përfaqësuesi i autorizuar nga pronari si dhe duke ju referuar pyetjeve të shpeshta të publikuara në ueb faqen e KRPP, gjegjësisht pyetja 40. Në lidhje me këtë pyetje KRPP ka bërë shfuqizimin me datën 01/11/2022 të një numri shumë të madh të pyetjeve ku përfshihet edhe pyetja 40 që ka të bëjë me nënshkrimin e deklaratës nën betim. Duke ju referuar kriterit të përmendur në këtë pyetje të dhëna në sqarimin e ekspertit, pretendimin ankimor e vlerëson si të pabazuar.
- *Konstatimi i dytë (II)*- Pretendimi ankimor i OE ankues është se autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë të GOE të rekomanduar për kontratë përmes email-it dhe jo platformës së e-prokurimit. Eksperti sqaron se pas pranimit të sqarimeve nga AK përmes emailit si ën bazë të dëshmive emaili vërehet se AK ka kërkuar sqarime shtesë përmes emailit dhe përgjigjet janë pranuar poashtu përmes emailit. Sipas emailave dhe duke ju referuar Rregullores për prokurim publik, neni 38 sqarimi i tenderit, sipas paragrafit 38.1 dhe 8 citoj: Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike., 38.8: "Kërkesën për sqarim të tenderit" AK duhet t'a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik. OE përgjigjen në “Kërkesën për sqarim të tenderit” duhet t'a dërgojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, andaj konform sqarimeve të dhëna si më lartë dhe Rregullores, eksperti e vlerëson pretendimin si të bazuar.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe vlerëson se ankesa e OE “Zona Park” është pjesërisht e bazuar.

Në fakt Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar nga ana e këtij Paneli. Kështu që pa nevojën që të përshkruhen sërish paneli mbështet shpjegimet dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar sikurse në raportin e ekspertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e këtij rasti Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me dispozitat ligjore, ka komunikuar me operatorin ekonomik përmes emailave dhe jo nëpërmjet platformës së e-prokurimit. Një veprim i tillë mund të

komprometojë besimin e palëve në procedurat e prokurimit publik, të cilat duhet të jenë transparente dhe llogaridhënëse andaj edhe në përputhje me Nenin 38.8 të Rregullores së Prokurimit Publik. Në këtë pikë paneli i fal besimin ekspertit të lëndës dhe pajtohet me gjetjet e tij.

Kështu që lidhur me çështjet e ngritura si objekt i kësaj ankese, paneli ka konsideruar gjetjet e ekspertit si të pranueshme, andaj rrjedhimisht është arritur në vendimin përfundimtar se lënda duhet të kthehet në rivlerësim për faktin parimor që komunikimet dhe dokumentacioni i ofruar nuk janë ngritur në platformën eprokurimi konform dispozitave të lartcekura si dhe lidhur me çështjen në lidhje me nënshkrimin e deklaratës nën betim nga personi i paautorizuar, Paneli Shqyrtues sqaron se konform raportit të ekspertizës i cili duke u bazuar edhe në pyetjet e shpeshta të KRPP-së ka potencuar se OE-të me autorizim të veçantë mund të autorizojnë përfaqësuesit e tyre, ndërsa sa i përket dyshimit mbi vërtetësinë e dokumentacionit të ngritur nga ana e OE ankues, paneli thekson se mbetet në përgjegjësi të plotë të AK-së në raste kur dyshohet mbi mashtrime dhe manipulime dokumentacioni të njejtat mund ti vërtetojë duke aplikuar nenet 72 dhe 59 të LPP-së duke ju drejtuar palëve pjesëmarrëse apo hartuesve të dokumenteve si dhe organeve kompetente në aspektin e hetuesisë në raste eventuale së paraqitjes së dyshimeve, andaj me qenë se aktiviteti kthehet në rivlerësim, AK bazuar në veprimet e ndërmarra mund ti ndërmarrë hapat që konsiderohen si të nevojshëm në harmoni me legjislacionin në fuqi, e poashtu lidhur me pretendimin e parashtruar nga pala ankuese se vetëm personat që kanë pozita menaxheriale mund të autorizohen si përfaqësues, paneli konsideron se AK në këtë rast mund të kërkojë interpretim nga KRPP në rast se kanë hasur në paqartësi lidhur me këtë pikë.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6, si dhe 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues nisat gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplisit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N.SH.H."ZONA PARK"**
- Arkivës së OSHP-së: